

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Drejtuar:

OE **“Ferro Beton & Construction CO” sh.p.k.,** **me NIPT K21505001Q**
Tiranë, Vorë, Km.20

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ **JO** ☐

OE “ENCOAL” sh.p.k. **me NIPT L51531003F**

Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga “Kavajës”, Zona Kadastrale Nr. 810, Nr. pasurie 5/92, 5/984, Garden Building, kati 11, 2B/11/1.

Tipi i Kontratës: Punë.

Numri i referencës së procedures: REF-73338-12-24-2025.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Fuqizim i linjës 110 kV Kafaraj - Vlora 1 - Babicë dopio qark dhe shtrirje përcjellësi në një qark”.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Datë 16.02.2026.

Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 16, datë 23.02.2026.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “Rafin Company” sh.p.k.**me NIPT L52152110A**

Vlera 427,115,000 (katërqind e njëzet e shtatë milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. OE “Ferro Beton & Construction CO”sh.p.k**me NIPT K21505001Q**

Vlera 487,098,000 (katërqind e tetëdhjetë e shtatë milion e nëntëdhjetë e tetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. OE “La-OR”sh.p.k**me NIPT K71420003R**

Vlera 493,930,930 (katërqind e nëntëdhjetë e tre milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë).

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**1. OE “Rafin Company” sh.p.k.****me NIPT L52152110A**

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.1, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme, për punime të kryera përsa i përket punimeve elektrike për linjat elektrike me nivel tensioni ≥ 110 kV. Sipas këtij kriteri, mjafton që OE ofertues të ketë cfarëdo lloj eksperience për punime të kësaj kategorie, por OE ofertues ka paraqitur vetëm kontrata për punime elektrike me nivel tensioni 35 kV. Sipas Procesverbalit të argumentimit, bashkëlidhur DST, ndryshimet mes këtyre niveleve të tensionit janë thelbësore dhe prandaj AK ka kërkuar që OE ofertues të ketë eksperiencë të ngjashme në kategorinë e punimeve me nivel tensioni ≥ 110 kV.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.3, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk disponon dhe as nuk ka marrëveshje kontraktuale me ndonjë subjekt që disponon programin e licencuar PLS CADD and Tower, sipas kësaj kërkesë. OE ofertues ka paraqitur disponibilitetin e programit MIDAS. Ky program rezulton që nuk ka ngjashmëri me programin PLS CADD and Tower, pasi ky i fundit përdoret nga inxhinierët elektrikë për të përgatitur linjat e tensionit elektrik, ndërsa programi MIDAS përdoret për përgatitjen e projekteve ndërtimore, si ura, rrugë, etj.

Në procesverbalin e argumentimit të kritereve, bashkëlidhur DST, është përcaktuar se AK përdor për projektimin e linjave softin PLS – CADD dhe shtyllat me PLS – TOWER. Në mënyrë që të analizohet lehtësisht projekti i hartuar nga kontraktori përveç dokumentacionit me ralcionin e printuar do të kërkohej dhe një kopje elektronike e projektit në CD. Kjo do të jete në formatin “.bak” dhe me pas do të ekstraktohet nga stafi teknik i OST për të kontrolluar projektin e linjes e paraqitur për aprovim, llogaritjet e shtyllave ngarkesat mekanike dhe kriteret me koeficientet e sigurisë se aplikuar.

Të gjithë të dhënat e sipërcituara, nuk mund të realizohen nga përdorimi i programit MIDAS, i cili nuk përdoret për këtë qëllim.

Gjithashtu, është kërkuar në pikën 2.3.3, që OE ofertues duhet të disponojë edhe një inxhinier elektrik të licencuar për përdorimin e programit PLS CADD and Tower, por OE ofertues ka paraqitur punonjësi K. Sh., i cili në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit është shënuar si punonjës inxhinier por pa specifikuar profilin e diplomimit të tij.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.7, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për të vërtetuar se disponon punonjësit e kërkuar me kartela të sigurimit teknik. Gjithashtu, edhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se OE ofertues të mos ketë specifikuar asnjë punonjës të tij nëse disponon kartelë të sigurimit teknik, në asnjë kategori.

Punonjësit që do të realizojnë kete kontrate, për arsye të natyrës teknike të saj dhe kushteve të punës në linjat e tensionit të lartë, duhet të respektojnë rregulloren e sigurimit teknik elektrik, bazuar në dispozitat ligjore përkatëse për punimet mbi 1000 Volt, në lartësi, me heqje dhe pa heqje tensioni, duke rrespektuar largësinë me tensionin nominal të punës për linjat 110 kV e lart.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.12, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur tabelën me të dhënat teknike, të produkteve që ofron, sipas kërkesës së këtij kriteri. Në këtë kriter, është theksuar se mosplotësimi i saktë i kësaj table është element skualifikimi. Kjo tabelë është kërkuar që të plotësohet nga OE ofertues me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara si dhe do i jepte mundësi AK për të gjykuar mbi plotësimin e apo jo të specifikimeve teknike të produkteve të ofruara.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “Ferro Beton & Construction CO” sh.p.k., me NIPT K21505001Q**, Adresa: Tiranë, Vorë, Km. 20, se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **487,098,000 (katërqind e tetëdhjetë e shtatë milion e nëntëdhjetë e tetë mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 9, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të procedohet siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit.

PO ☐ JO ☒